

Ditari Natyres

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A
"Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
Nr. 18 Viti i dytë i botimit Nëntor 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Mbahet në Kukës takimi i Tretë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
- Festohet Dita e Drinit
- Turizmi i qëndrueshëm duhet të jetë prioritet për Zonat e Mbrojtura në rajon
- Fushatë ndërgjegjëse mbi vlerat e biodiversitetit
- Mbahet në Budva takimi i Rrjeteve mjedisore
- Simpoziumi i 5-të për mesdheun mbi vegetacionin detar
- Organizohet trainimi "Si të organizojmë një fushatë të suksesshme" (Milieukontakt)
- Lançohet projekti SAIMON (Milieukontakt)
- Njoftime

Mbahet në Kukës takimi i Tretë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Kukës 2 Tetor 2014 — Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të organizatave partnere të rrjetit. Ky takim kishte si



shqipëria JO! DUHANIT

shqiperiajoduhanit.al

 0800 40 40

qëllim kryesor diskutimin e ecures së punës të Rrjetit deri më tani si dhe aktiviteteve të radhës në Rrjet. Një vend të veçantë zuri diskutimi me anëtarët e Rrjetit ndërtimi i faqes web mbi Parqet Kombëtare Shqiptare. Kjo faqe do të jetë e aksesueshme për publikun e gjërë dhe me mjaft informacione jo vetëm mbi bukuritë, vendndodhjen, sipërfaqen, foto etj të parqeve tona kombëtare, por edhe çfarë ofrojnë ato për turistin.

Gjithashtu në këtë takim Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës mbështeti nismën "**Shqipëria JO Duhanit**".

Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUP
Bashkejto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Festohet Dita e Drinit

Kukës 3 Tetor 2014 — INCA në bashkëpunim me



shoqatën Mbrojtja e Mjedisit Kukës si dhe me Këshillin e Qarkut Kukës organizuan disa aktivitete ndërgjegjëse e sensibilizuese në qytetin e Kukësit.



Aktivitetet kishin për qëllim sensibilizimin e opinionit për vlerat natyrore të Pellgut të Drinit. Ato filluan me një prezantim të trashëgimisë natyrore të Kukësit si dhe vizitën e ekspozitës fotografike me pamje nga natyra e Qarkut Kukës.

Veprimtaritë vijuan me maratonën simbolike, ekspozitën me krijime të frymëzuara nga natyra të

nxënësve të shkollës "Avni Rustemi" e kombinuar me ekspozimin e disa llojeve të bimëve bimëve medicinale dhe objekteve të fosilizuara që gjenden në rajonin e Kukësit.

Veprimtaritë në shënim të Ditës së Drinit u përmbyllën me një udhëtim me traget në Liqenin e Fierzës. Në këto veprimtari morën pjesë përfaqësues organizatave mjedisore pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, përfaqësues të Qarkut Kukës, përfaqësues të OJF të tjera të zonës, nxënës dhe qytetarë të Kukësit.



Turizmi i qëndrueshëm duhet të jetë prioritet për Zonat e Mbrojtura në rajon

Brijuni, Kroaci - 150 njerëz nga 13 vende europiane u mbledhën këtë javë në Kroaci për të folur rreth asaj se si zonat e mbrojtura dhe trashëgimia e tyre natyrore mund të gjenerojnë përfitime për njerëzit. Konferenca e organizuar nga WWF Adria u finalizua me nënshkrimin e një marrëveshjeje mes 60 parqesh të Rajonit të Parqeve Dinarike (14 prej tyre shqiptare) që zotohen të jenë pjesë vitale e rrjetit rajonal. Rëndësia e ngulitjes së konceptit të turizmit të qëndrueshëm dhe zbatimi i tij në zonat e mbrojtura ishin temat kryesore të Konferencës së tretë të Parqeve Dinarike, e cila u zhvillua nga datat 7-9 Tetor, 2014 në Parkun Kombëtar të Brijunit. Kjo

është hera e tretë që organizata për mbrojtjen e natyrës WWF mbledh drejtuesit, stafin dhe ekspertët nga zonat e mbrojtura të rrjetit të Harkut Dinarik me objektivin për të mësuar, bashkëpunuar dhe ndarë përvojat.

Pas konferencës së vitit të kaluar në Budva, ku u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit për zonat e mbrojtura mes Shqipërisë, Bosnjës -Hercegovinës, Malit të Zi, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Serbisë, konferenca e këtij viti vë theksin në ngritjen e Shoqatës Rajonale të Parqeve Dinarike, e cila do të vazhdojë punën e nisur nga Parqet Dinarike.

Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2 "Fenomenet natyrore rrallë ndalen në kufij politikë, prandaj mbrojtja e natyrës nuk mund të ndalet në kufijtë tanë shtetërorë. Qëllimi kryesor i kësaj iniciative rajonale është motivimi i vende fqinje për të bashkëpunuar, për të menaxhuar më lehtë dhe me efektivitet zonat e mbrojtura si dhe për të rritur cilësinë e jetës së popullatës lokale përreth tyre." - deklaroi ministri kroat i mjedisit, z. Mihael Zmajlović dhe vazhdoi me tej- "në Kroaci ne jemi

krenarë për 8 parqet tona kombëtare e 11 natyrore dhe prandaj ne po përdorim investimet

për të zhvilluar turizmin e qëndrueshëm dhe përmirësuar ekonominë lokale".

Rajoni i Harkut Dinarik zotëron një kapital të tillë natyror që WWF e konsideron me rëndësi globale për biodiversitetin. Ky është territori më i pasur me ujëra në Mesdhe, mban pyllin e virgjër europian, kanionin i dytë më të thellë në botë, etj. Rajoni është krenar për popullatat e kafshëve të mëdha si; rrëqebulli, ariu, ujku dhe më shumë se 5.000 specie unike. "WWF i konsideron zonat e mbrojtura si vendin ku ruhet trashëgimia natyrore magjike e këtij rajoni dhe njerëzit mund të përfitojnë me zgjuarsì prej tyre. Shoqata e Parqeve Dinarike do të ndihmojë zonat e mbrojtura të jenë efektive në arritjen e këtij misioni", - tha drejtori i WWF Mesdhe, z. Paolo Lombardi. "Ne të gjithë duhet të punojnë me qeveritë, sektorin e biznesit, shoqërinë civile dhe komunitetet lokale në mënyrë që njerëzit që jetojnë rreth parqeve mund të përfitojnë nga zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe mbrojtja e

natyrës."

Drejtori i Parkut Kombëtar të Brijunit, z. Sandro Dujmovic duke përshëndetur pjesëmarrësit nga 13 vende europiane tha - "Brijuni e meriton me të drejtë nderin për të pritur ekspertët e njohur dhe pjesëmarrësit e shumtë të Konferencës së Harkut Dinarik. Ai është i njohur për negociatat shumë të rëndësishme dhe marrëveshjet historike që janë bërë këtu, dhe në të njëjtën mënyrë kjo konferencë

mbledh njerëzit e fushës së mbrojtjes së natyrës nga të gjitha vendet e rajonit të Harkut Dinarik, duke treguar qartë dëshirën për të mbrojtur ekosistemin e Parqeve Dinarike në një zonë nga Sllovenia në Shqipëri. Kjo është arsyeja pse mbledhja e Parqeve të Harkut Dinarik në Brijuni është një ngjarje e rëndësishme, jo vetëm për Europën

Juglindore, por edhe për të trashëgimisë natyrore globale. Tema e konferencës është turizmi i qëndrueshëm në zonat e mbrojtura, dhe

Parku Kombëtar Brijuni në këtë kontekst paraqet një shembull të suksesshëm të harmonisë mes turizmit, mbrojtjes së natyrës, vlerësimit të trashëgimisë natyrore, gjeologjike dhe kulturore ". Rëndësia e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm u diskutua në shumë aspekte gjatë konferencës tre-ditore dhe paneli i ekspertëve u drejtua nga Presidenti i sapo zgjedhur i Federatës Europark, z. Ignace Schops. Rezultatet e vlerësimit të përfitimeve nga ekosistemet e 57 parqeve kombëtare në rajon u paraqitën përgjate ditës së dytë të Konferencës ndërsa krijimi i Shoqatës së Parqeve Dinarike do të bëhet zyrtarisht në fund të këtij viti.



Fushatë ndërgjegjësimi mbi vlerat e biodiversitetit

Shkrel 10-13 Tetor 2014 — Në kuadër të projektit “Ruajtja e Agro biodiversitetit në Zonat Rurale të Shqipërisë”(CABRA), zbatuar nga GIZ, u zhvilluan disa aktivitete me nxënësit e shkollave 9-vjeçare në Komunat Lekbibaj dhe Shkrel, në bashkëpunim me Institutin për Ruajtjen e Natyrës, mbi vlerat e biodiversitet dhe zhvillimin e qëndrueshëm në këto zona. Orët e veçanta u zhvilluan me dy grup moshë të ndryshme, me fëmijët e moshës 9-10 vjeç dhe 12-13 vjeç, në të cilat qëllimi kryesor ishte shtimi i njohurive tek fëmijët dhe ndërgjegjësimi mbi vlerat e zonës dhe potencialin turistik e bujqësor që ato ofrojnë. Orët u zhvilluan me pjesëmarrje interaktive të fëmijëve, të cilët u përfshinë në diskutime dhe ju dedikuan prezantime të shkurtra me foto, filma të shkurtër edukativ dhe lojra. Filmat ishin një përmbledhje e njohurive të mëparshme por edhe njohurive të reja dhe gjithashtu përmbanin mesazhe të nismave globale mbi zhvillimin e qëndrueshëm,



rëndësisë së specieve në zhdukje etj. Këto orë të veçanta të biologjisë prekën disa koncepte si: biodiversiteti, zinxhiri ushqimor, zhvillimi i qëndrueshëm etj. Fëmijëve të grup moshës 12-13 vjeç në program ju dedikua edhe një hapsirë për pikturën nëpërmjet të cilës ata shprehën konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm në fshatin e tyre.

Mbahet në Budva takimi i Rrjeteve mjedisore

Budva, Mal i Zi - 24-25 Tetor 2014 - U organizua në Budva të Malit të Zi takimi rajonal i Rrjeteve Mjedisore për shkëmbimin e eksperiencave, informacionit dhe forcimit të bashkëpunimit midis



organizatave mjedisore shqiptare dhe atyre malazeze.


Rrjeti “Për Mbrojtjen e Natyrës” me lider INCA-n i përbërë nga 8 organizata ishte i pranishëm me përfaqësues të Mbrojtja e Mjedisit-Kukës, Forumi Liqeni Shkodrës- Shkodër, Miqësia-Ulëz, Gren & Clean- Korçë, dhe Çajupi-Gjirokastrë. Përfaqësues të rrjeteve prezantuan punën e bërë deri më tani, dhe aktivitetet që do të realizoheshin deri në fund të vitit. Në emër të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës” foli z. Genti Kromidha.




Rrjeteve Mjedisore Shqiptare dhe atyre të Malit të Zi.

Ky takimi u zhvillua në kuadër të programit SENiOR-A i cili financohet nga Ambasada Suedeze me mbështetjen e REC Albania. Në takim morën pjesë katër rrjete mjedisore nga shqipëria dhe 8 organizata nga Mali i Zi. Takimi shërbeu për shkëmbimin e eksperiencave të deri tanishme midis

Simpoziumi i 5-të i mesdheut mbi vegjetacionin detar



Portoroz, Slloveni 27-31 Tetor 2014 — U zhvillua në Ptoroz të Sllovenisë Simpoziumin e 5-të për Mesdheun në lidhje me Vegjetacionin Detar, ku stafi i INCA-s paraqiti me ane të disa posterave punën e bërë deri më tani në lidhje me studimin shumë dimensional të zonës së Porto Palermos.



MAPPING OF MARINE HABITATS IN PORTO PALERMO BAY TO SUPPORT ESTABLISHMENT AND ZONING OF FUTURE MPA



Genti KROMIDHA, Zamir DEDEJ
Institute for Nature Conservation in Albania
e-mail: genti.kromidha@inca-al.org

Porto Palermo is a protected bay with very limited access in former time (until 1961), as it was a military area. Due to this, the area is presumed to be rich in marine biodiversity, although the surveys were very limited. Several studies, including the 2013 Marine and Coastal Protected Areas Strategic Action Plan, have proposed the area to be established as a MCPA.



Figure 1: Aerial view of Porto Palermo bay (Photo: INCA)

The main sources of threat to biodiversity values in Porto Palermo bay area include fishing activities, aquaculture, boat anchoring and coastal constructions causing permanent destruction and alteration of natural habitats, or decreases of habitat size and its fragmentation. Invasive species (*Caulerpa racemosa* var. *cyllindroica*, *Filipia stipulea* and *Pernon gibbesi*) are also present in Porto Palermo area.



Material and methods

The study has covered an area inside the Porto Palermo and the intermediate surroundings towards north and south of the bay. The investigation has been organized in surveying transects starting from the coastline and midlittoral, infralittoral, until the upper circumlittoral. A total of 24 surveying transects were covered. An underwater video-recorder was used for the survey in the infra-littoral, starting from 3-4 m depth, until the upper circumlittoral. Mapping of habitats has been carried out using ARCGIS software.




Figure 2: Rocky seabed (INCA)



Figure 3: Rocky seabed with a diver (INCA)

The results are focused on highlighting most important marine habitats, species and associations. Particular attention has been paid to the vulnerable/sensitive Mediterranean habitats and species of national and international conservation interest (Bern Convention, EU Habitat Directive, Albania Red List of Species).



Figure 4: Map of benthic communities and habitats present in Porto Palermo

Figure 5: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 6: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 7: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 8: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 9: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 10: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 11: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 12: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 13: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 14: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 15: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 16: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 17: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 18: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 19: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 20: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 21: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 22: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 23: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 24: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 25: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 26: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 27: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 28: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 29: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 30: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 31: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 32: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 33: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 34: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 35: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 36: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 37: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 38: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 39: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Figure 40: Underwater view of a rocky seabed (INCA)

Discussion and conclusions

The ecological study has identified biodiversity rich areas as well as areas under pressure from human activities. The survey shows that future MPA should include not only areas within the Porto Palermo bay but also extending north and south to its immediate surroundings covering an overall area of 20,68 km². The analysis of threats suggest that it is necessary to establish the marine protected area as soon as possible and develop a sound system of management zones and rules for development/controlling of activities within the MPA in order to provide for the conservation of important biodiversity values.

Acknowledgements

This poster is prepared in the frame of the project "Support planning, zoning and development of a Marine Protected Area in the Porto Palermo Bay (Albania), based on sound scientific and socio-economic knowledge" supported by IAC/SIPA.

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/kreu/item/355-simpoziumi-i-5-te-per-mesdheun-mbi-vegjetacionin-detar>

<https://www.facebook.com/MedmpAnet/posts/686442374785777>

https://www.facebook.com/inca.inca.756/posts/358045844363012?notif_t=like

Si të organizojmë një fushatë të suksesshme

Anëtarët e rrjetit **ECIM** zhvilluan më 30 shtator trajnimin: “**Si të organizojmë një fushatë të suksesshme**”.




Trajnimi u fokusua mbi dëmet që sjell ndërtimi i Hec-eve në zonën e Shebenik Jabllanicës. Parku Kombëtar i Shebenik-Jabllanicës shtrihet në verilindje të vendit tonë në kufinjtë e administrimit pyjor të Librazhdit. Me vendim të këshillit të ministrave zona është shpallur park kombëtar me vlera të larta ekoturistike. Në zonë mund të gjejmë monumente natyrore, peizazhe turistike, kisha, shtëpi tradicionale guri. Gjithashtu zona ka dhe vlera të veçanta hidrografike siç janë lumenjtë, përrrenjtë, liqenet, burimet, etj.

Ekspertët mjedisor të pranishëm në këtë trajnim dhanë disa informacione për pasojat që i kanosen zonës. Ndërtimi i Hec-eve do bëjë të mundur tharjen e lumenjve të zonës dhe dëmtime të shumta në biodiversitet. Banorët të irrituar nga situata e krijuar kanë zhvilluar protesta duke kërkuar anulimin e konçesioneve të dhëna jashtë çdo kriteri mjedisor. Si pasojë e revoltës janë pezulluar 13 leje por shumë të tjera vazhdojnë punën duke dëmtuar resurset natyrore të zonës.

Organizatave të rrjetit ECIM të shqetësuara për këtë fakt

që tashmë është kthyer në një problematikë edhe për lumenjtë e tjerë në Shqipëri (mund të përmendim këtu Langanicën dhe kanionet e saj në Vjosë) hartuan një strategji me aktivitete konkrete për mbrojtjen e parkut Kombëtar të Shebenik Jabllanicës i cili së fundmi është propozuar të jetë pjesë e UNESCO.

Synimi i kësaj fushate është bashkëpunimi mes aktorëve kyç për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.



Cështja e ngritur nuk i përket vetëm një grupi organizatash të shoqërisë civile por na përket të gjithëve pasi po na dëmtohen një e nga një lumenjte, pyjet dhe parqet më të bukura në të gjithë vendin.

Përveç të tjerave trajnimi shërbeu dhe për forcimin dhe bashkëpunimin e rrjetit ECIM në aktivitete të tjera në të ardhmen.

“**Si të organizojmë një fushatë të suksesshme mjedisore**” ishte moduli që u përdor dhe ju prezantua pjesëmarrësve në trajnim i përgatitur nga Milieukontakt Shqipëri për OJFtë të cilat duan të dinë më shumë mbi hapat e një fushate të suksesshme.

Nga Mileukontakt Albania

Lançohet projekti SAIMON

Rrjeti satelitor i monitorimit në kohë reale të rrezikut të eutrofikimit të ujërave detare në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri mbledhi në Janinë përfaqësues të Milieukontakt Shqipëri, Qarkut Vlorë, ekspertë të mjedisit dhe Administratës së Decentralizuar së

Drejtorisë së Ujrave të Epirit. Objekt i këtij takimi ishte vendosja e një bashkëpunimi në nivel të lartë midis dy vendeve drejt zgjidhjeve për problemet e përbashkëta duke zbatuar veprime të koordinuara për mbrojtjen e mjedisit dhe sidomos të ujërave të

Vijon në faqe 7

Faqe 6

Vijon nga faqe 6 bregdetit nga rreziku i eutrofikimit.

Ujrat bregdetare dhe cilësia e tyre është një ndër prioritet e qeverisë shqiptare dhe për rrjedhojë edhe e qeverisë vendore sespe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonës. Zbatimi i Direktivës kuadër të Ujit dhe bashkëpunimi e koordinimi mes institucioneve janë mjaft të rëndësishëm për stabilizimin e bashkëpunimit teknik dhe politik mes dy vendeve dhe do të jenë rezultat i këtij projekti. Monitorimi statelitor i ujrave detare dhe validitimi përmes kampioneve të marra në zona të ndryshme të bregdetit të jugut do të sigurojë të dhëna reale dhe në kohë për cilësinë e ujrave, rrezikun e eutrofikimit

dhe adresimin e problemeve dhe marrjen e masave.

Projekti po zbatohet në zonën bregdetare të Korfuzit, Thesprotisë dhe Vlorës. Partnerë në këtë projekt janë të gjithë autoritetet lokale përgjegjëse për ujërat detare: Administrata e Decentralizuar e Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, Rajoni i Ishujve Joniane dhe Këshilli i Qarkut Vlorë.

Në takimin e tetorit midis të tjerave u diskutua sesi të rritet ndërgjegjësimi i publikut për nevojën e mbrojtjes së mjedisit dhe informimi i vazhdueshëm i tij dhe institucioneve të tjera mbi gjetjet e monitorimeve dhe masat e marra për garantimin e cilësisë së ujrave bregdetare.

Nga Mileukontakt Albania

NJOFTIME

- 1- Jobs at Plant life Volunteer Coordinator (Plant surveys)
http://www.plantlife.org.uk/about_us/jobs_at_plantlife/
- 2- The Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF) and BirdLife International, in its role as the Regional Implementation Team (RIT) for the Mediterranean Basin Hotspot, invites Letters of Inquiry for large grants (from \$20,000 to \$150,000) to **promote civil society involvement in Integrated River Basin Management**.
 - ☐ The deadline for submission: Monday 24th November 2014
 - ☐ Eligible Strategic Direction: 2
 - ☐ Eligible countries: Albania, Macedonia, Montenegro and Morocco.Applications should be submitted online here: <https://leaf.conservation.org/Loi/New/10>
For more information on the call for proposal, please see the attachment or the [CEPF website](#)
Applicants are encouraged to discuss project ideas and eligibility with the RIT at: cepf-med-rit@birdlife.org

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania